



13-09-2021

Prishtinë / Priština

Nr./Br. 2279-2021

Në bazë të autorizimeve të dhëna me nenin 7.1 pika (a) dhe (b), nenin 64.2 pika (g) të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më 13.09.2021, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për Certifikimin e Listës Përfundimtare të Votueseve për Zgjedhjet Lokale 2021

- I. Certifikohet Lista Përfundimtare e Votueseve, për zgjedhjet lokale 2021, që do të mbahen më datën 17.10.2021.
- II. Obligohet Sekretariati i KQZ-së për zbatimin e këtij vendimi.
- III. Raporti përfundimtar për Certifikimin e Listës Përfundimtare të Votuesve është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 13.09.2021

Kryesues i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Kreshnik Radonich





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës

17 Tetor 2021

Lista Përfundimtare e Votuesve

2021

PËRMBAJTJA

QËLLIMI.....	3
PËRMBLEDHJE.....	3
PËRSHKRIM.....	4
PERIUDHA E SHËRBIMIT TË VOTUESVE.....	5
KËRKESA PËR KËSHILLIN GJYQËSOR.....	5
PERIUDHA E KUNDËRSTIMIT DHE KONFIRMIMIT E LISTËS SË VOTUESVE.....	6
REGJISTRIMI I VOTUESVE JASHTË KOSOVËS.....	6
KRIJIMI I LISTËS PËRFUNDIMTARE TË VOTUESVE.....	7
REKOMANDIMET PËR AGJENCINË E REGJISTRIMIT CIVIL.....	7
PËRMBLEDHJE TABELORE	
(Numri i votuesve, numri i QV, numri i VV dhe numri i votuesve për qendra të votimit).....	8

SHTOJCA 1: Shembull se si duken faqet e Listës Përfundimtare të Votuesve për vendvotimin e rregullt.

1. Qëllimi

Në bazë të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është e obliguar që të certifikoj listën e votuesve në raport me zgjedhjet e caktuara¹. Ky dokument e mbështetë procesin e certifikimit të listës së votuesve për Zgjedhjet e Lokale në Republikën e Kosovës, , që do të mbahen me datën 17 tetor 2021.

2. Përmbledhje

Lista Përfundimtare e Votuesve (**LPV 2021**) për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës bazohet në Ekstraktin e Regjistrimit Qendror Civil². Ky ekstrakt është përpiluar nga Agjencia e Regjistrimit Civil, gjegjësisht Departamenti i Prodhimit të Dokumenteve (DPA), në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

- I. Lista Përfundimtare e Votuesve 2021 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës përmban:
 - **1,885,448** emra të votuesve, me dallim prej **90,586³** votues më shumë, në krahasim me Zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 14 shkurt 2021.
- II. Numri i Qendrave të Votimit (QV) është **tetëqind e tetëdhjetë e tre (883)**. **Pesë (5)** qendra të votimit më pak se në Zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 14 shkurt 2021, dhe
- III. Numri i vendvotimeve është **dymijë e katërqind e shtatëdhjetë e shtatë (2,477)**. **Nëntëdhjetë e pesë (95)** vendvotime më shumë se në Zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 14 shkurt 2021.

¹ Ligji Nr. 03/L-256, Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Neni 64.2, pika (g).

² Ibid, Neni 7.1, pika (a) dhe (b).

³ 83,488 votues jashtë vendit në Zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të datës 14 shkurt 2021, të cilët janë kthyer si votues në listën e votuesve brenda Kosovës.

3. Përshkrimi

Pas pranimit të ekstraktit nga Regjistri Qendror Civil, Divizioni i Shërbimit të Votuesve, ka bërë caktimin e votuesve në qendra të votimit.

Numri i votuesve të rinj që do të votojnë për herë të parë në Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, më 17 tetor 2021 është: **41,012 votues**.

- a) **24,697 votues** të rinj që pas Zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të datës 14 shkurt 2021 kanë arritur moshën tetëmbëdhjetë vjeç dhe që do të votojnë për herë të parë në Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës më 17 tetor 2021.
- b) **8,937 votues** që nuk kanë qenë në Listën Përfundimtare të Votuesve në Zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës 2021, e që mund të konsiderohen si votues të regjistruar për herë të parë në Regjistrin Qendror Civil midis dy palë zgjedhjes ose votues që janë pajisur me dokumente të Republikës së Kosovës pas zgjedhjeve lokale 2017.
- c) **7,378 votues** që nuk kanë qenë votues në Listën përfundimtare të votuesve në Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës, të datës 14 shkurt 2021, për arsye se kanë pasur dokumente të lëshuara nga UNMIK-u, konsiderohen votues që janë pajisur me dokumente të Republikës së Kosovës për datën 14 shkurt 2021.
- d) Numri i votuesve të larguar nga lista e votuesve brenda Kosovës, e që janë regjistruar si votues të suksesshëm në listën e votuesve jashtë Kosovës për Zgjedhjet Lokale 2021, është 14,504.
- e) Numri i emrave të personave që janë larguar si të vdekur pas Zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të datës 14 shkurt 2021, është: 18,252⁴.
- f) Numri i emrave të personave që janë larguar për arsye se kanë hequr dorë nga shtetësia e Republikës së Kosovës pas Zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të datës 14 shkurt 2021, është: 1,158.

⁴ 14,081 emra të personave të vdekur janë larguar si rezultat i verifikimit nga të dhënat e verifikuara të pranuar nga Departamenti i Pensioneve, në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.

4. Periudha e shërbimit të votuesve

Periudha e Shërbimit të Votuesve ka filluar me datën 20 korrik 2021 dhe ka përfunduar me datën 7 shtator 2021.

Gjatë kësaj kohe, të gjithë votuesit kanë pasur mundësi të informohen për qendrën e votimit ku janë caktuar dhe të kërkojnë ri caktim të qendrës së votimit sa më afër vendbanimit.

Gjatë kësaj periudhe, makina kërkuese është shfletuar 245,099 herë.

Numri i kërkesave për ndërrimin e qendrave të votimit është: **8,439**.

- a) **6,345** kërkesa për ndërrim të qendrave të votimit janë parashtruar përmes aplikacionit online në ueb faqen e KQZ-së.
- b) **2,094** kërkesa për aplikim janë parashtruar në zyrat e Komisionit Komunal Zgjedhor, përmes formularëve të aplikimit për ndërrim të qendrave të votimit.
 - **7,669 kërkesa** janë aprovuar,
 - **770 kërkesa** janë refuzuar, për këto arsye:
 - për shkak që votuesit kanë kërkuar ndërrim të qendrave të votimit në qendrat e votimit split, ku ndarja e votuesve bëhet në bazë të shkronjave të para të mbiemrit, dhe
 - për shkak që nuk kanë dëshmuar identitetin.

Pas kësaj periudhe, Divizioni i Shërbimit të Votuesve ka vendosur të gjitha ndryshimet në listën e votuesve, e cila më pas është integruar në ekstraktin e fundit që është pranuar nga Agjencia e Regjistrimit Civil/ Departamenti i Prodhimit të Dokumenteve.

5. Kërkesa për Këshillin Gjyqësor të Kosovës

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me datën 10.08.2021 ka dorëzuar kërkesën në Këshillin Gjyqësor të Kosovës, me qëllim të pajisjes me të dhëna e qytetarëve që u është marrë zotësia e veprimit.

Nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës nuk kemi pranuar të dhëna ashtu siç është kërkuar.

6. Periudha e Kundërshtimit dhe Konfirmimit e Listës së Votuesve

Periudha e Kundërshtimit dhe Konfirmimit e Listës së Votuesve ka filluar me datën 24 gusht 2021 dhe përfunduar me datën 7 shtator 2021.

Përgjatë kësaj periudhe nuk ka pasur asnjë rast të kundërshtimit të listës së votuesve në gjykatat e shkallës së parë.

7. Regjistrim të votuesve jashtë Kosovës

Periudha e Aplikimit për Regjistrim të Votuesve jashtë Kosovës ka filluar me datën 10 korrik 2021 dhe ka përfunduar me datën 18 gusht 2021.

Divizioni i Shërbimit të Votuesve ka dërguar aplikacione për regjistrim dhe udhëzimet për regjistrim, të gjithë aplikuesve që kanë aplikuar për regjistrim në Zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të datës 14 shkurt 2021.

Përgjatë periudhës së aplikimit për regjistrim, përmes adresave elektronike dhe përmes postës, janë pranuar **18,852 aplikacione për regjistrim**.

- 15, 532 aplikacione për regjistrim janë aprovuar, dhe
- 3, 320 aplikacione për regjistrim janë refuzuar.

Tabela2: Të dhënat për kategoritë e refuzimit.

KATEGORITË E REFUZIMIT	NR. I APLIKACIONEVE TË REFUZUARA
Mos plotësimi i kriterëve juridike.	1,351
Aplikuesit nën moshën 18 vjeç (në ditën e zgjedhjeve, 17 tetor 2021 nuk i mbushin 18 vjeç).	8
Aplikacione që nuk janë konfirmuar pas thirrjeve telefonike, si shkak e-mail adresat të dyshimta.	1,172
Aplikuesit që kanë hequr dorë nga shtetësia e Republikës së Kosovës.	255
Aplikacionet e pranuar në kutinë postare, që nuk kanë përmbajtur vulën dhe pullën postare të postës dërguese.	101
Aplikacione të dërguara jashtë rrethit të ngushtë familjarë, nga një e-mail adresë.	352
Aplikacionet e verifikuara përmes telefonit, ku aplikuesit kanë konfirmuar se nuk kanë aplikuar personalisht.	81
TOTALI:	3,320

8. Krijimi i LPV-së

Pas përfundimit të Periudhës së Shërbimit të Votuesve dhe Periudhës së Konfirmimit dhe Kundërshtimit të LV-së, Divizioni për Shërbim të Votuesve i ka caktuar votuesit nëpër vendvotime sipas renditjes alfabetike. Të dhënat e reja janë shtypur në format PDF dhe kualiteti është kontrolluar nga ana e Divizionit të Shërbim të Votuesve. Këto dokumente janë të gatshme për t'ju dërguar operatorit ekonomik, i cili do të bëjë shtypjen e Listës Përfundimtare të Votuesve 2021.

9. Rekomandimet për Agjencinë e Regjistrimit Civil/ Regjistrin Qendror Civil

Divizioni i Shërbimit të Votuesve vlerëson bashkëpunimin e ngushtë dhe profesional me Agjencinë e Regjistrimit Civil.

Lidhur me proceset e ardhshme të krijimit të Listës së votuesve, Divizioni i Shërbimit të Votuesve ofron këto rekomandime:

- a) Në këtë proces zgjedhor, edhe pse votuesit kanë marrë letërnjoftim në komunën e caktuar, por të dhënat nuk janë reflektuar në regjistrin qendror civil. Andaj, ARC-ja duhet që të gjitha të dhënat e ndryshuara, të reflektohen me kohë.
- b) Agjencia e Regjistrimit Civil/ Ministria e Punëve të Brendshme duhet që sa më parë të fillojë integrimin e sistemit unik të adresave në bazën e të dhënave të shtetasve në Regjistrin Qendror Civil.
- c) Ministria e Punëve të Brendshme duhet të bëjë lidhjen e bazës së të dhënave të departamentit të prodhimit të dokumenteve, me bazën e të dhënave të departamentit të gjendjes civile, në aspektin e adresave, e që pastaj do të reflektohej në listën e votuesve.

10. Përmbledhje tabelore

1. Numri i votuesve, Numri i Qendrave të Votimit dhe Numri i Vendvotimeve për komunat e Republikës së Kosovës.

Kodi Komunal	Komunat	Numri i votuesve për komuna	Numri i Qendrave të Votimit	Numri i Vendvotimeve
01	Deçan	39875	14	50
02	Gjakovë	113165	34	139
03	Glllogoc	54908	29	73
04	Gjilan	101062	34	126
05	Dragash	39059	34	58
06	Istog	47693	21	60
07	Kaçanik	32647	21	46
08	Klinë	48305	20	60
09	Fushë Kosovë	40289	15	50
10	Kamenicë	35161	28	54
11	Mitrovicë e Jugut	78546	28	101
12	Leposaviq	12707	18	25
13	Lipjan	61045	34	82
14	Novobërdë	9367	18	22
15	Obiliq	24539	15	34
16	Rahovec	57618	35	78
17	Pejë	109051	24	130
18	Podujevë	83562	45	111
19	Prishtinë	195978	52	238
20	Prizren	173359	71	221
21	Skenderaj	53479	33	75
22	Shtime	27015	16	35
23	Shtërpçë	12410	9	18
24	Suharekë	66763	33	85
25	Ferizaj	111990	44	144
26	Viti	48084	31	66
27	Vushtrri	71684	32	98
28	Zubin Potok	6443	12	14
29	Zveçan	6879	7	12
30	Malishevë	54018	35	74
31	Junik	4527	1	5
32	Mamushë	4223	1	5
33	Hani i Elezit	8467	4	11
34	Graçanicë	20671	13	30
35	Ranillug	4884	7	10
36	Partesh	4579	3	7
37	Klllokot	3675	5	7
38	Mitrovicë e Veriut	17721	7	23
	TOTALI	1,885,448	883	2,477